

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	19 / 12 /		2023
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
	02-052/01-	60889	



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit



**Kuvendi
Komiteti për Komunitete**

PROPOZIM

**Komiteti për Komunitete me qëllim të realizimit të
detyrave të punës në përputhje me Rregulloren e
Punës së Komiteteve të Komunës së Drenasit dhe
Ligjin për Vetëqeverisje Lokale harton këtë:**

Raport të punës për vitin 2023

Hyrje

*Komiteti për Komunitete është organ i formuar nga
Kuvendi i Komunës së Drenasit në harmoni me Statutin e
Komunës dhe Rregullores së punës së Kuvendit.*

Misioni:

*Siç është përshkruar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale
Komiteti për Komunitete është përgjegjës për të trajtuar
çfarëdo çështje që ka të bëjë me diskriminimin e një
personi mbi çfarëdo baze siç është: gjuha, religjioni,
prejardhja etnike, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me
interesin e një komuniteti.*

*Komiteti për Komunitete përbëhet gjithsej 5 anëtarë , në
komitet është një përfaqësues i subjektit politik PDK një
përfaqësues i subjektit politik DD një përfaqësues i
subjektit politik LVV, një përfaqësues i Komunitetit të
Bizneseve dhe një përfaqësues i OJQ -së.*

Puna dhe Aktivitetet

*Gjatë vitit 2023 Komiteti për Komunitete ka mbajtur 6
mbledhje të rregullta.*

*Në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar frymë e mirë
bashkëpunimi dh janë trajtuar çështje të rëndësishme.*

Në fillim të muajit Shkurt 2023 ëshë mbajtur mbledhja e parë për këtë vit ku temë e diskutimit ishte "Plani i Punës për vitin 2023", pasi secili nga anëtarët ka dhënë idetë e tyre lidhur me këtë plan, me vota unanime është miratuar Plani i Punës për vitin 2023 si dhe është caktuar orari i mbledhjeve të planifikuara përgjatë vitit.

Në muajin Maj komiteti ka mbajtur një mbledhje ku temë diskutimi ishte "Gjendja e Arsimit në Komunën e Drenasit", për të diskutuar për këtë temë ishte i ftuar Drejtori i Arsimit në komunën e Drenasit z. Muhamet Gjoka, anëtarët e komitetit i kanë parashtruar pyetje dhe sugjerime z. Gjoka lidhur me çështjet me të cilat përballet arsimi në komunën tonë. Temë tjetër në këtë mbledhje ishte "Raport nga Zyra për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Drenasit", ku për të diskutuar për këtë temë ishte prezente znj. Afije Veseli. Znj. Afije para anëtarëve raportoi për punën dhe aktivitetet e kësaj zyre.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Qershor temë diskutimi ishte: "Gjendja me Vërshimet në Komunën e Drenasit", i ftuar për të diskutuar për këtë temë ishte Drejtori i Shërbimeve Publike në komunën e Drenasit z. Nexhmedin Gruda. Z. Gruda bashkë me anëtarët diskutuan për gjendjen pas vërshimeve në komunën e tonë.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Shtator, për të raportuar nga Zyra për Komunitete dhe Kthim në komunën e Drenasit ishte e pranishme znj. Afije Veseli.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Tetor, për të diskutuar për temën "Inspektimi i Bizneseve në komunën e Drenasit" ishte i ftuar drejtori i Inspektoriatit në komunën e Drenasit z. Petrit Sinani. Z. Sinani bashkë me anëtarët e komitetit diskutuan lidhur me punën e kësaj drejtorie me theks të veçantë inspektimin e bizneseve.

Në mbledhjen e fundit që u mbajt në muajin Nëntor, temë diskutimi ishte "Raport nga Zyra për Komunitete dhe Kthim"

dhe "Aktivitetet e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport".
Raportin për mbledhjen e fundit para anëtarëve e paraqiti
znj. Afije Veseli.

Për të diskutuar për temën e dytë prezent ishte
perfaqësuesi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport zAgim
Kastrati.

Ai para anëtarëve tregoi për punën dhe aktivitetet e kësaj
drejtorie.

Përgjatë vitit, kryesuesi ka takuar qytetarë të
shumtë, problemet e të cilëve i ka adresuar edhe në
takimet e komitetit.

Drenas, Dhjetor 2023



Kryesuesi i Komitetit

Drin Halilaj